



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 1694/prot.  
3

Tiranë, më 03.12.2020

Lënda: Kthim përgjigje shkresës nr.4076/1 prot. dt. 27.11.2020.

INSTITUCIONIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS  
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM

E nderuar Znj. Zonja,

Në përgjigje të shkresës Tuaj nr. 4076/1 prot. dt. 27.11.2020, Ju informojmë si më poshtë:

**Së pari;** Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) më datë 16.11.2020, ka publikuar në Faqen Zyrtare të tij, listën e kandidatëve prokurorë, të cilët plotësojnë kushtet ligjore për t'u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi (KED) për vitin 2021 si dhe listën e kandidatëve që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore në këtë proces.

**Së dyti;** Kandidatët të cilët nuk plotësonin kushtet dhe kriteret ligjore për tu zgjedhur anëtarë të KED-së, bazuar në nenin 221 pika 5, të Ligjit nr.115/2016, datë 03.11.2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, janë njoftuar individualisht lidhur me këtë vendim, konkretisht;

- Znj. Irma Balliu
- Z. Arqilea Koça
- Z. Elvin Gjokaj
- Z. Artan Bajrami
- Z. Alfred Agolli
- Z. Ferdinand Elezi
- Brahim Dragjoshi

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit nuk ka asnjë ankim lidhur me këtë vendim nga kandidatët e skualifikuar si dhe afati ligjor për ushtrimin e ankimit ka kaluar.

***Së treti;*** Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) në hartimin e listës me kandidatët për tu zgjedhur anëtarë të KED-së, ka vlerësuar sipas përcaktimeve ligjore të nenin 221, të Ligjit nr.115/2016, datë 03.11.2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, ku ndër të tjera thuhet se:

*1. Mund të përfshihen në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vetëm ata magistratë dhe gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, të cilët, në momentin e organizimit të shortit, plotësojnë kushtet e mëposhtme:*

*a) në kohën e hedhjes së shortit magistrati e ka ushtruar funksionin për të paktën 10 vjet;*

*b) nuk ka një masë disiplinore në fuqi;*

*c) nuk ka filluar një procedim disiplinor para kandidimit;*

*ç) shfuqizuar;*

*d) shfuqizuar;*

*dh) magistrati është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në 2 vlerësimet e fundit etik dhe profesional;*

*e) magistrati ose gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk është nën hetim ose nuk është dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;*

*ë) magistrati ose gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk është dënuar më parë me sanksion administrativ për shkelje të rregullave ligjore në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesave.*

Në zbatim të dispozitave të sipërpërmendura, KLP ka ndjekur procedurën si më poshtë:

1. Për gërmat *a*, *b*, *c* dhe *dh* në zbatim të ligjit nr.115/2016, datë 03.11.2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organi përgjegjës për burimet njerëzore të prokurorisë dhe për këtë qëllim me vendimin nr.96 datë 15.04.2020 “Për krijimin dhe administrimin pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë të dosjes personale dhe regjistrin të prokurorëve” dhe në zbatim të ligjit për gërmat e lartëpërmendura informacioni është nxjerrë nga sistemi ynë që disponohet nga zyra e Burimeve Njerëzore pranë KLP-së. Nga verifikimi i kryer rezulton se magistratët kandidatë për KED plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara nga gërmat *a*, *b*, *c* dhe *dh*.
2. Në zbatim të gërmës *e* të nenit të lartëpërmendur Këshilli i Lartë i Prokurorisë i është drejtuar me shkresë nr.1638 prot datë 17.11.2020 të gjithë zyrave të Prokurorive të Republikës së Shqipërisë lidhur me faktin nëse këta prokurorë janë në hetim dhe janë administruar përgjigjet në të cilat rezulton se këta prokurorë nuk janë në hetim.

Me shkresën nr.1647 datë 19.11.2020 Këshilli i Lartë i Prokurorisë i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe nga përgjigja e ardhur rezulton se këta magjistratë nuk janë dënuar më pare me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

3. Me shkresën nr 1639 prot. Datë 17.11.2020 Këshilli ka kërkuar informacion pranë Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe nga përgjigja e ardhur prej këtij institucioni rezulton se ndaj prokurorëve kandidatë për KED, nuk janë vendosur sanksione administrative, si dhe ndaj tyre nuk janë referuar kallëzime penale.

Në përfundim të procesit, ju bëjmë me dije se kandidatët e propozuar në listën e përcjellë pranë jush, për tu zgjedhur anëtarë të KED-së plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore të përcaktuara në ligj.

Ju faleminderit për mirëkuptimin,

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**  
**EMIS CËRAVA**

